

VENDIM
Nr. 609, datë 11.9.2012

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 587, DATË 10.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DHËNIEN NË PËRDORIM NË FORMËN E HUAPËRDORJES PA
KUNDËRSHPËRBLIM, TË NJË PJESE TË TRUALLIT TË NDËRMARRJES SË QYMYRGURIT
VALIAS, KAMËZ, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 87587 M², SHOQËRISË “THE
AMERICAN INTERNATIONAL SCHOOL SYSTEM-ALBANIA” (AISS), SHPK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008 dhe të neneve 901 e vijues të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 587, datë 10.8.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në pikën 1 fjalët “... pa kundërsHPërblim,...” zëvendësohen me “... me çmimin 1 euro ...”.
 2. Në pikën 2 fjalët “... pa afat ...” zëvendësohen me “... me afat 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vjet ...”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYEMINISTRI
Sali Berisha